

The background of the book cover is a collage of historical photographs. In the top left, a group of men in formal attire stands behind a white railing. In the top right, a red flag with a gold eagle emblem is visible. In the bottom center, a group of people, some wearing white head coverings, are gathered in an outdoor setting.

1912
DHE
UNGJILLI

XHEJMS KLARK

Titulli: 1912 dhe Ungjilli

Autori: Xhejms Klark – (James Clarke)

Përktheu: Laura Clarke

Redaktoi: Laura Clarke

E drejta e botuesit në gjuhën shqipe: © AEM-Misioni

Ungjillor, Gjirokastër, Albania (Shtator 2012)

Botoi: AEM-Misioni Ungjillor, Shtator 2012

Email: libraria@aemission.al

Të drejtat e rezervuara: Asnjë pjesë e këtij botimi nuk duhet të riprodhohet, të vendoset në ndonjë sistem, ose të transmetohet nëpërmjet çdo formë apo mënyrë, elektronike, mekanike, fotokopjimi, inçizimi apo në ndonjë mënyrë tjetër pa marrë më parë leje me shkrim nga (AEM) botuesi.

Citimet biblike janë marrë nga Bibla Diodati i Ri (1991-1994) përveç në Pasthënie. Citimet biblike në

Pasthënie janë marrë nga Dhjata e Re, Versioni ABS (2002) që gjendet në Bibla e Studimit Jeta e Plotë. E drejta e autorit © SHOQERIA BIBLIKE

SHQIPTARE (A.B.S.) TIRANE. Përdorur me leje.



Komisioni i Alfabetit, Manastir 1908

1. Gjergj Fishta
2. Mit'hat Frashëri
3. Luigj Gurakuqi
4. Gjergj Qiriazi
5. Ndre Mjeda
6. Grigor Cilka

7. Taçi Buda
8. Shahin Kolonja
9. Sotir Peci
10. Bajo Topulli
11. 11) Nyzhet Vrioni

Hyrje

Gjashtë muaj pasi shqiponja dykrenore u ngrit më 28 Nëntor 1912 në një ballkon në Vlorë, Ismail Qemali ishte në Londër në Konferencën e Ambasadorëve. Në kohën kur ishte atje, ai shkoi për vizitë tek disa të krishterë ungjillorë anglezë ‘që t’i falenderonte për gjithë ndihmën që i kishin dhënë çështjes shqiptare’. Ata ishin ‘Shoqëria Biblike Britanike dhe e Huaj’. Në 1912 Mid’hat Frashëri gjithashtu pohonte se ‘Shoqëria Biblike’ ishte bërë ‘e nderuar dhe e lavdëruar pothuajse nga të gjithë shqiptarët

patriotë, qofshin myslimanë apo të krishterë.’ Por cilët ishin këta njerëz dhe çfarë kishin bërë ata për Shqipërinë që të meritonin lavdërim të tillë?

Pesë vjet më parë kishte ndodhur një nga ngjarjet më domethënëse në historinë shqiptare – Kongresi i Manastirit i 1908. Disa prej pjesëmarrësve më të rëndësishëm aty ishin besimtarë ungjillorë shqiptarë si Gjergj Qiriazi zëvendëspresidenti i shoqërisë ‘Bashkimi’, pastor Grigor Cilka (të dy shihen në foton sipër) dhe Parashqevi Qiriazi – e vetmja delegate grua.

Edhe më parë 1908 ishin të krishterë ungjillorë të tjerë si Gjerasimi (vëllai i madh i Gjergjit), besimet dhe patriotizmi

i të cilit u kombinuan për ta bërë një figurë me ndikim të madh në rizgjimin kombëtar shqiptar.

Pavarësisht se nuk është mjaft e njohur, të krishterët ungjillorë dhanë një kontribut vital ndaj Pavarësisë së Shqipërisë dhe ishin në zemër të lëvizjes patriotike për gjuhën shqipe. Për fat të keq ky kontribut u mohua gjatë komunizmit në Shqipëri dhe madje edhe sot shumë njerëz janë të paditur për pjesën që kanë luajtur ungjillorët në historinë shqiptare – shumë supozojnë në mënyrë të gabuar se ungjillorët erdhën për herë të parë në Shqipëri pas viteve 1990! Më në fund, në 2011 komuniteti ungjillor u njoh zyrtarisht si një prej

pesë feve zyrtare të Shqipërisë. Shumë historianë shqiptarë dinë për historinë e ungjillorëve në Shqipëri para Luftës së Dytë Botërore dhe kanë shkruar për ta, siç është historiani Xhevat Loshi, por mes shqiptarëve sot, shumë njerëz nuk janë akoma në dijeni të kësaj historie të fshehur.

Ungjillorët e marrin emrin e tyre prej Ungjillit, lajmit të mirë të Jezus Krishtit. Ky libër i shkurtër është një paraqitje e përmbledhur e pjesës që të krishterët ungjillorë shqiptarë dhe të huaj kanë luajtur në Pavarësinë e Shqipërisë dhe tregon se si Ungjilli ka qenë i ndërthurrur me historinë e popullit shqiptar. Për të kuptuar arsyen përse ka

ndodhur kjo, duhet kuptuar se çfarë është Ungjilli. Në fund do të gjeni një përmbledhje të shkurtër të kuptimit të tij i shkruar nga një pastor ungjillor shqiptar.

Panorama Historike

*“Prej Jeruzalemit e përqark dhe
gjer në Iliri, kam kryer shërbimin
e ungjillit të
Krishtit.”*

— **Apostulli Pal, duke
shkruar në vitin 57 pas K.,
Romakëve 15:19**

Të krishterët ungjillorë e marrin emrin e tyre nga Ungjilli i Krishtit (εὐαγγέλιον në greqishten e Biblës). Termi ‘Ungjillor’ u përdor për herë të parë nga të krishterët protestantë për të theksuar

faktin se besimet e tyre nuk bazoheshin në traditat apo organizatat njerëzore, por në ‘të vërtetën e ungjillit’ – i cili është mesazhi i shpëtimit në Bibël. Ashtu si apostulli Pal, ungjillorët besuan dhe predikuan ungjillin e Krishtit.

“Unë, Gjoni, biri i Benedikt Buzukut, duke u kujtuar shumë herë se gjuha jonë nuk kishte gjë të kuptueshme nga shkrimi i shenjtë, për të dashurit e botës sonë, desha me u përpjek, për sa munda me ditë, për të ndriçuar pak mendjet e atyre që të kuptojnë, për sa ata të mund të marrin se sa i lartë dhe i fuqishëm dhe i përmëshirshëm është Zoti në ndaj atyre që e duan atë me

gjithë zemër."

Original: "U Donih Gjoni, biri hi Bdek Buzukut, tue u kujtuom shumë herë se gluha jonëh nukë kish gjaa të endigluom ensëh shkruomit shenjtë, ensëh dashunit sëh botësë sanëh, desha me u fëdigunëh për saa mujtah meh ditunëh, meh zditunë pak mendetë e atyneh qi t'eh endiglonjinëh, për seh ata tëh mundëh mernëh saa hi naltë e hi mujtunë e hi përmishëriershim anshtë Zotynë atyneh qi tah duonë em gjithëh zemërë."

Ungjilli nuk është aspak diçka e re për shqiptarët. Është një fakt mjaft i njohur historik që një nga vendet e para që

dëgjoi ‘Ungjillin e Krishtit’ ishin viset të cilat ne i njohim sot si Shqipëria. Ata paraardhës të hershëm të Shqipërisë që dëgjuan ungjillin dhe e vunë besimin e tyre te Jezus Krishti besuan në të njëjtën kohë siç bënë edhe banorët e Jeruzalemit, Romës, Athinës dhe kjo përpara shumicës së botës. Historiani Daniele Farlati regjistron se nga viti 58 pas K. tashmë kishte një grup të konsiderueshëm besimtarësh në Durrës.⁴ Që prej asaj kohe, ungjilli ka luajtur një pjesë të rëndësishme në historinë e Shqipërisë. Shumë prej dokumenteve të para të shkruara në shqip lidhen me këtë. ‘Meshari’ i Gjon Buzukut përmban citime nga

ungjilli.⁵ Ashtu edhe veprat e Pjetër Budit. Ndërsa titulli i plotë i veprës së Pjetër Bogdanit ‘Çeta e Profetëve’ në fakt është: ‘Çeta e profetëve përsa i përket Krishtit, Shpëtimtarit të Botës dhe e Vërteta e tij e ungjillit.’^{6,7}



PERANDORIA OSMANE, 1801

Gjithashtu gjatë rilindjes shqiptare ungjilli pati një rol të rëndësishëm. Në këtë kohë dihej se të paturit e një forme të shkruar të shqipes ishte jashtëzakonisht jetësore për shpëtimin e identitetit shqiptar nga shkrirja

me pushtuesit dhe fqinjët e vet. Vendosja e alfabetit standard të shqipes u konsiderua si hapi drejt pavarësisë. Në fakt në Kongresin e Berlinit (13 Qershor 1878) ndërsa Serbia, Mali i Zi dhe Rumania fituan njohjen si shtete të pavarura, aplikimi i Shqipërisë prej Abdyl Bej Frashërit u refuzua me justifikimin se: ‘S’mund të ketë një komb pa gjuhë të shkruar.’ Njohja e Shqipërisë varej në arritjen e një forme standarde të shkruar të gjuhës së saj unike. Por kjo nuk do të ishte e lehtë të realizohej. Si autoritetet turke ashtu edhe ato greke me forcë shtypnin përpjekjet për të përhapur një shqipe të shkruar, duke qenë se nuk ishte në interesin e tyre politik. Ishte pikërisht në këtë moment kritik që

ungjilli, nëpërmjet
besimtarëve ungjillorë, dha kontributin e
tij më të rëndësishëm në Pavarësinë e
Shqipërisë. Librat e ungjijve dhe të
gramatikës që botonin dhe
shpërndanin ungjillorët ishin të vetmit
libra në gjuhën shqipe që autoritetet
turke nuk mund t'i ndalonin së
qarkulluari.

John Quanrud shpjegon në librin e tij *'A Sacred Task'* ('Një detyrë e shenjtë'): *"Tani autoritetet turke u përballën me një sfidë të papritur. Si rezultat i politikave të tyre agresive ndaj lëvizjes kombëtare shqiptare dhe të gjitha çështjeve të saj, Lidhja Shqiptare ishte shpartalluar,*

udhëheqësit e saj ishin burgosur ose ishin dërguar në mërgim. Vilajetet shqiptare ishin në një gjendje pothuajse nën qeverisje ushtarake, me autoritetet lokale në gatishmëri kundër shenjës më të vogël të ndonjë aktiviteti 'rebel'. Por dukej sikur lëvizja ishte përqafuar nga një kampion i papritur... ”⁸

Quanrud vijon të shpjegojë në këtë moment se shpërndarja e ungjillit në Shqipëri si dhe e librave të gramatikës shqipe të botuara nga ungjillorët çoi drejt *'përdorimit të gjerë të shqipes si një gjuhë e shkruar'*. Me të filluar kjo, ndodhi një efekt domino që çoi në standardizimin e gjuhës në

1908 (çelësi për ta çliruar Shqipërinë nga sundimi turk) dhe si rrjedhim drejt pavarësisë në 1912!

Shoqëria Biblike Britanike dhe e Huaj (SHBBH)

Kontributi ndaj 1912:

**Mbështetja e gjuhës së shkruar shqipe
Dhënia e Biblës tek shqiptarët në
gjuhën e tyre.**

Shoqëria Biblike Britanike dhe e Huaj (BFBS) është një organizatë ungjillore e themeluar në 1804, qëllimi kryesor i së cilës është t'ua bëjë njerëzve ungjillin të disponueshëm në gjuhën e tyre amëtare

që ata të mund të njohin Krishtin. Në shumë vende kudo në botë ku gjuha kishte vetëm formën e folur, ata kanë ndihmuar për të krijuar dhe përhapur një formë të shkruar të gjuhës në të cilën ungjilli atëherë mund të përkthehej dhe të botohej për përfitim shpirtëror të vendasve. Shpesh kjo përfshinte sakrificë të madhe personale të punëtorëve të shoqërisë.

“Nderim të drejtë mirënjohjeje për Shoqërinë Biblike për shërbimet që ajo i ka bërë vendit dhe letërsisë sonë... Në të vërtetë, është e pamundur të flitet për gjuhën dhe letërsinë e Shqipërisë pa sjellë ndërmend mundimet dhe përkushtimin

e atyre, që, për aq gjatë dhe përballë shumë vështirësive, e kryen këtë punë.”

**- Mit'hat Frashëri (Shqiptarët,
Kartë e pendë, fq 321)**

Në 28 gusht 1816, Rev. R. Pinkerton i shkroi ShBBH: *“Shoqëria Biblike Britanike dhe e Huaj duhet t'i kushtojë vëmendje të madhe pajisjes së shqiptarëve me të paktën Dhjatën e Re [përfshirë ungjijtë] në gjuhën e tyre. Ata ende nuk kanë asnjë pjesë të fjalës së Perëndisë në gjuhën e tyre... padyschim që pajisja e shqiptarëve me një Dhjatë të Re në gjuhën e vet do të ishte një qëllim i denjë i përpjekjeve të saj më të hershme dhe më të zellshme”.*

Në 25 tetor 1819 ai shkroi përsëri: “...
*përkthimi i Dhjatës së “Nderim të
drejtë mirënjohjeje për
Shoqërinë Biblike për shërbimet që ajo
i ka bërë vendit dhe letërsisë sonë... Në
të vërtetë, është e Re në gjuhën shqipe
është gërshetuar kaq fort rreth zemrës
sime këto vitet e fundit, sa vërtet
s’mund ta heq qafe...”*⁹

Përkthimi i parë.

Në këtë kohë, ‘*letërsia në gjuhën shqipe
pothuajse nuk ekzistonte fare, duke
qenë se ishte e ndaluar si nga
autoritetet shtetërore turke, ashtu edhe
nga Kisha Ortodokse
Greke.*

¹⁰ Gjithashtu nuk ekzistonte

asnjë alfabet standard i shqipes. Pavarësisht këtyre pengesave të mëdha, Shoqëria vendosi të përkthente ungjillin në Shqip. Në 1819 Pinkertoni shkoi për t'u konsultuar me Vangjel Meksin në Stamboll, i cili i ishte rekomanduar Pinkertonit si një përkthyes i mundshëm. Vangjel Meksi ishte një shqiptar i mirë-arsimuar me origjinë nga Labova, Gjirokastër. U lind në 1770. Pas studimeve në Janinë, u bë mjek në oborrin e Ali Pashës. Pas largimit nga oborri i Ali Pashës në 1810, Meksi filloi të zhvillonte një interes në krijimin e një gjuhe shqipe të shkruar. Ai shkroi një gramatikë të shqipes dhe shpiku një alfabet të ri të përbërë nga shkronja

greke dhe latine. Në 1814 botoi dy përkthime në shqip të librave fetare rreth Krishterimit të cilat fatkeqësisht kanë humbur.

ΔΙΑΤΑΞΗ

Ε ΖΟΤΙΤ ΕΔΕ ΣΦΛΒΪΣΙΤ Τ'ΥΝΕ

ΙΕΣΟΥ-ΚΡΙΣΤΙΤ,

ΚΕΘΥΕΜ ΠΡΕΙ ΓΡΕΚΪΣΤΕΣΕ ΒΙΕΤΕΡ

ΣΚΙΡ

ΝΔΕ ΓΥΗΕ ΓΕΓΕΝΙΣΤΕ

prei

KONSTANTINIT KRISTOPORIDIT, ELBASANASIT.



KONSTANTINOPOL.

Σίτουρ νδε Σταμβούλ, ωδα Πιλάκνδφιλέρ-Υολού, νδε Μαγαζίνε τε Βιβλίεσε.

Νδε Ιτύπα-Ικροήε τε Α. Η. Βογανιανίτ.

1872.

Çështja e madhe ishte cilat shkronja të përdorëshin për ungjillin. Në fund u zgjodhën shkronjat greke për këtë përkthim të parë. Edhe pse kjo nuk do të ishte një zgjedhje e përsosur, të paktën ata shqiptarë që dinin greqisht do të ishin menjëherë në gjendje të lexonin dhe të kuptonin ungjillin në shqip dhe t'u lexonin të tjerëve që nuk dinin greqisht. Kishte shkolla që mësonin greqisht dhe gjithashtu ekzistonte pak letërsi në këtë formë.¹¹ Pas këtij diskutimi, Shoqëria Biblike vendosi të punësojë Meksin për të përkthyer Dhjatën e Re në shqip duke përdorur shkronjat greke. Meksi e përfundoi punën në dy vjet, dhjetë muaj para nga afati përfundimtar i

kontratës.¹² Pasi e kishte përfunduar përkthimin, shpërtheu Lufta Greke për Pavarësi dhe Meksi iu bashkua forcave greke për të punuar si mjek dhe ndihmoi në rrëzimin e sundimit otoman. Ai vuajti disa herë nga pneumonia dhe vdiq shpejt pas kësaj. Në 1824 u botua ungjilli sipas Mateut si provë, ndërsa e gjithë Dhjata e Re u vendos nën kujdesin e Grigor Gjirokastritit i cili rishikoi punimin. Për shkak se ky përkthim ishte shkruar me shkronja greke, përdorimi i tij ishte i kufizuar, sidomos në veri të Shqipërisë. Pavarësisht kësaj, ky duhet të njihet si një hap i madh në themelimin e gjuhës shqipe si dhe në prurjen e Biblës tek shqiptarët në gjuhën e tyre amëtare.

Përkthimi i Dytë

Jo shumë kohë më vonë, Shoqëria Biblike punësoi Konstandin Kristoforidhin për të bërë përkthime të ungjillit të cilat do të bëheshin jashtëzakonisht të rëndësishme për zhvillimin e një gjuhe standarde të shkruar. I mirënjohur dhe mjaft i dashur prej shqiptarëve edhe sot, Kristoforidhi nuk ishte një ‘yll i vogël’ në zgjimin kombëtar shqiptar, por një dritë e madhe. Ai ishte një besimtar ortodoks, i lindur në 1830 nga një argjendpunues në Elbasan dhe dallohej që nga fëmijëria për dëshirën e tij të pashuar për studim. Ai shkoi në gjimnazin Zosimea në Janinë, një nga shkollat më

të mira të Ballkanit në atë kohë, ku ndihmoi gjithashtu albanologun e madh gjerman Johann Georg von Hahn, për të mësuar shqip dhe për të shkruar një fjalor Gjermanisht-Shqip.

*“Jisuj pra përsëri u foli atyre,
dyke thënë, ‘Unë jam drit’ e botësë,
ay që më vjen pas, nukë dot’
ecënjë nd’ errësirët, po dotë këtë
dritën’ e jetësë.”*

**- Një varg nga përkthimi
i Kristoforidhit i Ungjillit**

Kur mbaroi gjimnazin në 1851, shkoi në Maltë ku studioi për dy vjet në Kolegjin Protestant të Maltës. Atje mësoi italisht dhe anglisht. Pas kësaj ai punoi

në Shqipëri dhe pastaj punoi si përkthyes për trupat shqiptare që luftonin në luftën e Krimesë. Besohet se në 1856 Kristoforidhi shkoi në Londër ku përfundoi edhe një universitet tjetër. Ka mundësi të ketë qenë atje që ai hyri në kontakt me Shoqërinë Biblike Britanike dhe të Huaj e cila më vonë e punësoi për të bërë përkthimin i ri të ungjillit. Ç'është më e rëndësishme është që këtë herë, nuk do të ishte me shkronja greke, por me ato latine dhe në mënyrë të jashtëzakonshme në të dyja dialektet Toskë dhe Gegë! Këtë punë të pamatë ai e kreu në mënyrë shumë të ndërgjegjshme. Para se të përpiqej me përkthimin ai u kthye në Shqipëri për

pak kohë dhe udhëtoi nëpër krahina të ndryshme si Elbasani, Berati dhe Shkodra (tri qendra të mëdha të dialekteve) ku hyri në kontakt të afërt me njerëzit, duke mbledhur fjalë, fraza e shprehje për të pasuruar fjalorin e tij shqip. Me këmbëngulje të pazakontë ai përktheu fillimisht ungjijtë dhe pastaj pjesë të tjera të Biblës. Sipas albanologut të respektuar Robert Elsie ‘këto përkthime shërbyen si një themel për krijimin e një gjuhe letrare moderne, në dy variante dialektesh.’¹³ Ato gjithashtu shërbyen për të bërë të mundur që mijëra shqiptarë të njohin Krishtin duke lexuar Fjalën e Perëndisë në gjuhën e tyre amëtare.

‘Këto përkthime shërbyen si një bazë për krijimin e një gjuhe letrare moderne, në dy variante dialektesh.’

— Robert Elsie, Albanolog

Në vitet 1870 Kristoforidhi punoi për një farë kohe me Shoqërinë Biblike në Shqipërinë qendrore, duke shpërndarë ungjillin dhe duke këmbëngulur tek njerëzit për nevojën e studimit të shkrimeve në gjuhën e tyre. Në 1872 ai shpërndau mbi 1000 kopje dhe në 1874 mbi 1100! Kjo punë jetësore nuk do të kishte ndodhur në qoftë se nuk do të ishte për Shoqërinë Biblike Britanike dhe të Huaj.¹⁴

Alexander Thompson dhe librashitësit

Kontributi Kryesor për 1912:



Alexander Thompson

Shpërndarja e Biblës në gjuhën shqipe. Nxitja e hapjes së shkollave në gjuhën shqipe.

Ndërsa situata politike në Shqipëri ishte akoma e paqëndrueshme, një ungjillor skocez do të përfshihej shumë me Shqipërinë, dhe do të jepte një kontribut domethënës për popullin e saj. Alexander Thompson u lind në Skoci në 1820 dhe i jati ishte predikues. Pas një shkollimi në universitetet më të mira të Skocisë, Thompsoni u shugurua si misionar në 1845. Për 17 vjet punoi mes judenjve në Budapest dhe Stamboll deri në 1860 kur filloi punën me Shoqërinë Biblike Britanike dhe të Huaj si drejtor i punës në Turqi. Në 1863 ai

bëri një turne në Bosnje dhe Shqipëri. Mesa duket kjo për Thompsonin ishte fillimi i një dashurie dhe kujdesjeje të veçantë ndaj popullit shqiptar.

“Kur mendoj për shqiptarët mua më duket se nevoja e madhe është që të kemi shkolla ku fëmijët të mund të mësojnë gjuhën e tyre bashkë me fjalën e Perëndisë, dhe ku të mund t’u predikojmë atyre Jezusin Shpëtimtar.”

- Alexander Thompson. Një detyrë e shenjtë (A Sacred Task), fq. 44)

Më vonë për të u shkruajt se: *‘[Ai] vetë ndjen interesin më të thellë në popullin shqiptar dhe mendon për ta se meritojnë një vëmendje më*

*të përgjithshme se sa kanë marrë deri tani.*¹⁵ Ai pa se kishte një nevojë të madhe shpirtërore dhe fizike për popullin shqiptar, të cilët ishin shumë të shtypur dhe të neglizhuar. Ai besonte se shqiptarët kishin të drejtë të kishin një formë të shkruar të gjuhës së tyre amëtare edhe pse kjo nuk do t'i kënaqte turqit. Ai veçanërisht besonte se shqiptarët kishin një nevojë të madhe shpirtërore që ta zotëronin ungjillin në gjuhën e tyre në mënyrë që të njihnin Krishtin. Tani që ungjilli ekzistonte në shqip, ai pa nevojën tek njerëzit që jo vetëm të ishin të gatshëm ta merrnin atë, por edhe të përkushtohej kohë për t'i mësuar ata si të lexonin alfabetin e ri.

Gjatë dekadave të ardhshme Alexander Thompson, duke punuar për Shoqërinë Biblike, inkurajoi dhe mbikëqyri shumë shqiptarë dhe të huaj që ndërmorën këtë detyrë të rrezikshme për t'u sjellë shqiptarëve ungjillin në gjuhën e tyre. Gjatë kësaj kohe, lëvizja politike në Shqipëri kishte një ndikim destabilizues në shoqëri dhe udhëtimi nëpër vend ishte shpesh i rrezikshëm. Shënime magjepëse të punës së vështirë dhe sakrifikuese që kryen këta burra për të sjellë ungjillin në Shqipëri mund të lexohen në *'Rrugë Biblike në Shqipërinë e Vjetër'*¹⁶. Ata u përballën me kushte ekstreme moti, me rrezikun grabitjes nga kaçakët, me burgimin,

kundërshtimin e autoriteteve turke dhe Kishës Ortodokse Greke e cila denoncoi përkthimin e ungjillit në shqip. Për shembull, është interesante të lexosh për kohën që u merrte atyre për të udhëtuar atëherë nga njëri vend në tjetrin krahasuar me sot. Një librashitës mban shënim se udhëtimi nga Gjirokastra në Tepelenë donte 7 orë¹⁷ udhëtim që sot mund të bëhet në 25 minuta me makinë. Në këto kushte ata udhëtuan kudo në trojet shqiptare të cilat atëherë përfshinin edhe krahinat e Janinës dhe të Kosovës!

Gjerasim Qiriazhi

Kontributi Kryesor për 1912:



GJERASIM QIRIAZI

*Hapja e Shkollës së Parë të
Vashave Predikimi i ungjillit në
gjuhën shqipe.*

Familja Qiriazhi është mjaft e mirënjohur tek shqiptarët. Madje gjatë komunizmit u bë një film i bazuar në jetët e tyre i quajtur ‘Mësonjëtorja’ (ndonëse në të përdoren pseudonime). Ajo që shumë njerëz nuk e dinë është se familja Qiriazhi ishin të krishterë ungjillorë shqiptarë. Kontributi i tyre ndaj pavarësisë së Shqipërisë ishte i madh përmes përpjekjeve të tyre për të dhënë mësim gjuhën shqipe. Por ata nuk ishin të motivuar për ta bërë këtë vetëm nga patriotizmi, por nga një dëshirë për t’i bërë shqiptarët të aftë të

lexonin ungjillin në gjuhën e tyre amëtare.¹⁸

Gjerasim Qiriazhi u lind më 1858 pranë Manastirit. Në 1873 ai pati kontakt me ungjillin kur dy misionarë amerikanë erdhën në Manastir dhe morën me qira shtëpinë në krah të prindërve të tij. Në fillim Gjerasimi i ri shkonte bashkë me djemtë e tjerë për të shqetësuar takimet, por filloi ta konsideronte seriozisht mesazhin. Ai bleu një Dhjatë të Re të cilën e lexoi me kujdes. Kjo çoi në kthimin e tij në besim dhe ai u bë pjesë e kishës ungjillore atje në 1877.

Shumë shpejt u bë e qartë që Gjerasimi kishte një dëshirë të fortë për të ndarë lajmin e mirë të Jezus Krishtit me të

tjerët duke përfshirë edhe bashkëatdhetarët e tij. Në 1878 ai hyri në shkollën e misionit Samakov. Gjerasimi u diplomua në 1882 duke lënë pas ‘*një reputacion të shkëlqyer për dituri, aftësi, besnikëri, gjenialitet dhe devocion*’¹⁹. Pak më vonë ai filloi të shërbejë në një kishë bullgare, por kishte një dëshirë të zjarrtë t’u predikonte bashkëatdhetarëve të tij në gjuhën e tyre.

“Unë sapo kisha filluar të punoja për njerëzit e mi, dhe ditë pas dite dëshira për të predikuar Fjalët e Jetës tek ata po rritej... Zemra nuk më digjej as për pasuri e as për ndonjë gjë tjetër të kënaqshme për

*mishin. Kisha vetëm një gjë në
mendje – përhapjen e dritës mes
bashkatdhetarëve të mi.”*

- Gjerasim Qiriaz

Ai kishte dëgjuar për Alexander Thompsonin dhe që ai kishte të njëjtën dëshirë për t'u sjellë shqiptarëve ungjillin. I shkroi atij duke i sugjeruar bashkëpunim. Gjerasimi ofroi të vizitonte të gjitha qytetet kryesore dhe fshatrat e mëdha të Shqipërisë duke marrë ungjillin e botuar nga Shoqëria Biblike. Me një koinçidencë të mrekullueshme, pikërisht në të njëjtën kohë, Thompsoni i kishte shkruar Gjerasimit saktësisht të njëjtin sugjerim! Letrat e tyre u kryqëzuan rrugës! Pra

bashkëpunimi nisi dhe me 'gëzim e shpresë të madhe' Gjerasimi, së bashku me një punëtor tjetër të Shoqërisë Biblike, Sevastides, u nis në turneun e tij të parë në trojet shqiptare.

Gjatë këtij turneu ai i përjetoi edhe kundërshtimin që autoritetet turke ngrenin ndaj përhapjes së gjuhës shqipe, por edhe dëshirën e fortë që shumë nga njerëzit e tij të kishin fjalën e Perëndisë dhe lirinë nga sundimi turk. Në këtë turne të parë ai lexoi nga ungjilli në publik dhe shiti shumë nga përkthimet e Kristoforidhit si dhe librin e tij të Gramatikës Shqipe. Për shumë shqiptarë kjo duhet të ketë qenë hera e parë që dëgjonin fjalën e Perëndisë të lexohej në

gjuhën e tyre. Së bashku më bashkëpunëtorin e vet u burgos në Durrës, por u lirua menjëherë falë presionit nga ShBBH. Ata vazhduan për në Vlorë, Elbasan, Tiranë dhe Shkodër dhe falë presionit të ushtruar nga miqtë e tyre britanikë, autoritetet turke nuk mund të bënin asgjë për të ndaluar qarkullimin e lirë të librave shqip!

Ishte për këtë arsye që Ismail Qemali, Mid'hat Frashëri dhe shumë të tjerë ishin aq mirënjohës ndaj Shoqërisë Biblike. Në këtë kohë ungjijtë dhe Librat e tyre të Gramatikës ishin të vetmit libra shqip që autoritetet turke nuk mundën t'i ndalonin së qarkulluari mes shqiptarëve. Kur e kuptuan plotësisht 'kërcënimin

serioz të interesave turke,²⁰ që ngritën këta të krishterë shqipfolës, turqit u përpoqën ta shtypnin këtë rrezik të ri te autoriteti i tyre suprem. Porta e Lartë e akuzoi Gjerasimin dhe Sevastidesin që gënjyen për arrestimin e tyre në Durrës. Si pasojë, Ambasadori britanik u dekurajua nga mbështetja e punës së Shoqërisë. Veziri i Madh, Kuçut Sait Pasha, në mënyrë të fshehtë dha urdhër për t'i vonuar qëllimisht librat e Shoqërisë në një pikë doganore, në mënyrë që të pengonte shpërndarjen e tyre ndërkohë që ishte ndaluar botimi i mëtejshëm i ungjijve në Toskërisht. Gjatë kësaj kohe, Gjerasimi qëndroi në Stamboll ku studioi gegërisht

me Kristoforidhin dhe filloi të shkruante letërsi në shqip duke përfshirë edhe himne të krishtera. Çdo të djelë mbante shërbesa adhurimi në shqip. Shumë shqiptarë jetonin në Stamboll në atë kohë duke përfshirë shumë prej atyre që luajtën një pjesë të rëndësishme në pavarësinë e Shqipërisë, si vëllezërit Frashëri dhe anëtarë të Komitetit Shqiptar të Stambollit. Këtu Gjerasimi shprehu për herë të parë idenë e tij për të hapur shkolla ku shqiptarët mund të mësonin të lexonin gjuhën e tyre që të mund të kuptonin ungjillin. Por mbi këtë, dëshira e tij e ngutshme ishte të gjente një mënyrë për t'u kthyer në Shqipëri dhe të predikonte ungjillin në

gjuhën e nënës.²¹ Naim Frashëri në atë kohë ishte duke punuar në zyrën e Censurës nën Ministrinë e Arsimit dhe ishte në gjendje të ndihmonte.²² Mesa duket ishte falë ndikimit të tij që ndalimi mbi shkrimet shqipe të kthehej mbrapsht. Gjerasimi atëherë u kthye me një ngarkesë me ungjij në Manastir ku vazhdoi të predikojë te bashkëatdhetarët e tij. Ai u mirëprit dhe për herë të parë në Manastir filluan shërbesat e kishës në gjuhën shqipe. Shumë shprehën dëshirën për të mësuar si të lexonin dhe të shkruanin në shqip dhe së shpejti u desh të porositeshin më shumë Bibla në shqip nga Stambolli.

Skënder Luarasi shkroi një biografi të

Gjerasimit gjatë komunizmit e cila për fat të keq u censurua dhe u shtrembërua rëndë nga autoritetet.

Megjithatë, çuditërisht, mbeti paragrafi i mëposhtëm i cili shënon se si e perceptonin fëmijët

Gjerasimin: *“Fëmijët në lagje shpesh i afroheshin. Gjerasimi mbyllte librin e tij, i përqafonte dhe niste bisedën me ta për gjëra të afërta për zemrat e tyre. ‘Ai flet si Krishti!’, tha një nga vogëlushët. Shumë prej këtyre që vinin nga shtëpi shqiptare, ku flitej shqip, të djelave shkonin te salla e misionit protestant kur mësonin se do të predikonte Gjerasimi, që ata ta dëgjonin atë ‘të fliste si Krishti.’”²³*

Fatkeqësisht, kundërshtimi prej armiqve të gjuhës shqipe po merrte një formë ogurzezë. Autoritetet greke, që i kishin sytë tek tokat të cilat i pretendonin të tyre, ishin kaq të shqetësuar për të shtypur identitetin shqiptar, sa që edhe peshkopët ortodoksë grek e ulën veten derisa ta shtypnin fjalën e Perëndisë në gjuhën shqipe.²⁴ Ndërsa Gjerasimi ishte në një udhëtim të lodhshëm për në Korçë, karrocieri papritur e ngadalësoi shpejtësinë në grykën e Laithizës. Disa minuta më vonë një bandë kaçakësh u shfaq, të udhëhequr nga kriminel i famëkeq Shahin Matraku. E gjitha dukej e planifikuar. Pasi e rrëmbyen e detyruan të shkruante

këtë shënim për ta liruar me
shpërblim.²⁵

TË DASHUR PRINDËR,

*Jam kapur nga kaçakët dhe duan
pesë mijë lira si shpërblim për lirim.*

**- Gjerasim D. Qiriaz, Mali i
Thatë, 13 nëntor 1884”**

I rraskapitur dhe i uritur, ata e merrnin
me vete zvarrë rreth maleve duke pritur
për lajmin e shpërblimit, të cilën
Gjerasimi kishte shpjeguar se nuk do të
vinte pasi familja e tij ishte e varfër. Në
këtë situatë të dëshpëruar mendimet e tij
të trazuara janë regjistruar në vetë fjalët
e tij. Ato janë prekëse dhe zbulojnë
motivin e tij në jetë: “*Mendimet e mia
ishin: ‘Cili do të jetë rezultati i kësaj?’*”

Arrita në përfundimin se nuk dilja i gjallë nga kjo. Jo vetëm që s'kisha asnjë para, por ishte dimër dhe një sëmundje do ishte e mjaftueshme për të më dhënë fund në male, pa një vend për të pushuar dhe në duart e kaçakëve. U pikëllova jo aq shumë për jetën time, sesa për punën time. Sapo kisha filluar të punoja për njerëzit e mi, dhe ditë për ditë dëshira ime për të predikuar Fjalët e Jetës tek ata po rritej... Zemra nuk më digjej as për pasuri as për ndonjë gjë tjetër të kënaqshme për mishin. Kisha vetëm një gjë në mendje – përhapjen e dritës tek atdhetarët e mi. Pse duhet Perëndia atëherë të më harrojë? Ndërsa e shqetësoja mendjen

time me këto mendime, pashë në largësi një lule të bukur që kishte shpuar rreth dy centimetra dëborë dhe ngrihej gati një gisht mbi të. Kur pashë lulen, qëndrova dhe e këqyra... Thashë: 'Nëse Perëndia kujdeset për këtë lule, e cila s'është asgjë në sytë e njerëzve këtu në dëborë dhe i dhuron asaj bukuri, sa më shumë do të kujdeset Ai për ata që i besojnë Atij?' M'u kujtuan fjalët e ungjillit: 'Vini re si rriten zambakët e fushës: ata nuk lodhen dhe nuk tjerrin; dhe unë, pra, po ju them se Salomoni vetë, me gjithë lavdinë e tij, nuk ishte veshur si ndonjë nga ata. Tani nëse Perëndia e vesh kështu barin e fushës, që sot është dhe nesër hidhet në furrë,

*vallë nuk do t'ju veshë shumë më tepër
ju, njerëz besimpakë?' (Mateu 6:28-
30). Këto fjalë i kuptova më mirë. Ishte
një mësim i çmuar për mua. Mora
zemër.”²⁶*

Pas gjashtë muajsh të hidhur në robëri,
më në fund u siguroa lirimi i
Gjerasimit, por shëndeti i tij nuk e mori
asnjëherë veten dhe besohet se ka
shkaktuar vdekjen e tij të parakohshme.
Pas lirimit të tij, në vend që të hiqte dorë
nga puna, vendosmëria e Gjerasimit për
të përhapur ungjillin vetëm sa u rrit për
arsye se besonte që ishte e vetmja kurë e
sigurtë për mjerimin shoqëror të popullit
të tij.²⁷ Gjatë katër viteve në vazhdim ai
udhëtoi shumë kudo në Shqipëri duke

predikuar ungjillin në shqip. Ai formoi Vëllazërinë ungjillore dhe së bashku me motrën e vet, Sevasti Qiriaz, hapi Shkollën e Parë Shqipe të Vashave në 1891. Mësueset në shkollë përbëheshin nga motrat e tij Sevastia dhe Parashqevia, Fanka Efthimi dhe Polikseni Luarasi.

Ekzistenca e shkollës e tërhoqi klerin grek të qytetit i cili mesa duket, në 1893 dërgoi një person për të vrarë Gjerasimin. (Kjo skenë është portretizuar gjithashtu në filmin '*Mësonjëtorja*'). Vrasësi kishte pirë që të gjente guxim, por fatmirësisht s'e realizoi dot vrasjen pasi ishte i dehur! Më vonë atë vit, pjesërisht për

shkak të shëndetit të rënë që kishte patur
që nga koha kur ishte marrë peng, dhe
pjesërisht nga stresi që jeta e tij ishte
vazhdimisht nën kërcënim, Gjerasim
Qiriazi ra i sëmurë dhe vdiq në 2
Janar 1894, në moshën 35 vjeçare. Është
shënuar se pavarësisht vuajtjeve të
tij, në shtratin e tij të vdekjes ai mbeti
plot me ngushëllim, me gëzim në
Zotin dhe ndjeu guxim të ri për t'u folur
drejtpërdrejt dhe me ngut vizitorëve
të tij për shpëtimin e madh – kuptohet në
gjuhën shqipe. Poema e tij e mëposhtme
përmbledh veprën e jetës së tij:

*Do punonj për mëmëdhenë
Gjith jetën sa të rronj
Do të zgjonj dhe ata që flenë*

*Kështu jetën do mbaronj
O vëllezër shqiptarë
Merrni sot udhën' e mbarë
Punën tuaj mos harroni
Kohs shkon dhe prapë s'vjen.²⁸*

Sevasti Qiriazhi

(1871-1949)

Kontributi Kryesor për 1912:



Sevasti Qiriazhi

Hapja e Shkollës së Parë Të Vashave së bashku me Gjerasimin

Nga familja e saj në Manastir, me ndihmën dhe inkurajimin e Gjerasimit, Sevastia shkoi të studionte në Kolegjin Robert në Stamboll. Ajo ishte e para grua shqiptare në atë kohë që shkoi të studionte në universitet. Gjatë kohës që ishte atje, një ditë arriti të bindte drejtorin e një burgu që ta lejonte të vizitonte patriotin Koto Hoxhi në birucën e tij. Ajo e përshkruan këtë takim:

“Një vrimë e qelbur! Një rreze drite që zbriste nga një e çarë nga lart më ndihmoi që të shquaja një figurë të mjeruar. Ai qëndronte i shtrirë mes një

kapice me leckë mbi një rrasë guri që shërbente si shtrat. Ishte Koto! “Tungjatjeta Koto!” guxova, më në fund, të mërmëris. Me një zë të hollë, që mezi dëgjohej, ai pyeti: “Kush po më flet kështu? Duhet të jetë ndonjë zë qiellor i dërguar nga Perëndia për t’i folur një fjalë të butë zemrës sime të plagosur.” Pamja e tij ishte aq e mjeruar, sa që ndjeva lot të nxehtë që më rridhnin nëpër faqe...I folamës ngashërimave: “Kam ardhur, o atë i dashur, që të të sjell një fjalë kurajoje dhe të të rrëfej se, ndonëse të kanë hedhur në këtë birucë që të heqësh të zitë e ullirit, fara që ti mbolle ka lëshuar fryte të mbara. Shpirti yt

jeton në zemrën e popullit tënd.”
Figura e leckosur u përgjigj: “Po. Ata
më kanë lidhur trupin me zinxhirë, por
shpirti im është i lirë. Ai është i
lirë dhe nuk ka torturë që të më ndalojë
së thirruri: ‘Jo! Nuk vdes Shqipëria! Së
shpejti ajo do të jetë e bashkuar, e
*pavarur dhe e lumtur’.”*²⁹

Në ceremoninë e diplomimit të saj nga Kolegji Robert, Naim Frashëri foli dhe tha: “*Motra ime e vogël, nuk do të bëjë*
gjë më të mirë e më të vyer për
Shqipërinë nga ç’ke vendosur të bësh
për arsimin e grave të
vendit tonë.” Pasi përfundoi studimet e saj, kur u kthye në shtëpi, së bashku me të vëllanë, Gjerasimin, themeloi në

Korçë shkollën e parë shqipe të vashave në 1891. Sevastia dhe Gjerasimi ishin të bindur se ishte e drejta e fëmijëve të mësonin të lexonin dhe të shkruanin në gjuhën e tyre amëtare. Kur vdiq Gjerasimi në moshë të hershme në 1894, Sevastia vazhdoi punën me heroizëm pavarësisht kërcënimeve të vazhdueshme prej autoriteteve turke dhe klerit grek. Ajo ishte vetëm 23 vjeç.



Shkolla e parë shqipe e vashave, Korçë 1899

Në foto dallohen mësuesja Poliksena Luarasi dhe mësuesi patriot Thanas Sina.

Sevastia u martua me Kristo Dakon në 1910. Në 1912, në Manastir, Sevasti Qiriazhi botoi një *‘Gramatikë Elementare për Shkollat Fillore’* dhe *‘Shkronjëtoe e Gjuhës Shqipe’*. Gjithashtu përgatiti disa tekste historike për botim. Fatkeqësisht, pas pavarësisë, familja Dako u detyrua të jetonte përmes vuajtjeve shumë të vështira dhe të dhimbshme.

Në 1922, ata themeluan Institutin Qiriazin në Tiranë e cila ishte e ngjashme me liceun francez në Korçë. Në 1927 Instituti u zhvendos diku tjetër ku u zgjerua për të përfshirë një bibliotekë të pasur, kompleks sportiv dhe program më të gjerë edukimi. Për rolin e tyre të madh që ajo dhe bashkëshorti i saj, Kristo Dako, patën në historinë e Shqipërisë, u dekoruan me Urdhërin e Skënderbeut. Megjithatë për shkak të lidhjeve të tyre me perëndimin dhe besimit të tyre fetar, pas Luftës së Dytë Botërore, Enver Hoxha i pa me një sy tjetër. Kjo është paksa ironike duke marrë në konsideratë se gjatë luftës ishin nazistët që keqtrajtuan familjen Dako (Qiriazin)

për shkak se ishin patriotë. Gestapoja kishte arrestuar të gjithë familjen siç e shpjegon John Quanrud: “Sevastia, atëherë në të shtatëdhjetat, bijtë e saj me gratë e tyre dhe fëmijët e vegjël, dhe Parashqevia të gjithë u dërguan në një kamp përqendrimi afër Beogradit. Ata ia dolën të mbijetonin dhe u kthyen në Shqipëri në 1945 pas një udhëtimi të gjatë dhe të vështirë.”³⁰

“Mësuesja e guximshme [e shkollës], Zonjushë Qiriazhi, drejtonte me një aftësi dhe entuziazëm që meriton lavdërimin më të lartë. Dhe pavarësisht faktit se marrja pjesë në shkollë do të thoshte që prindërit dhe fëmijët rrezikonin

*përndjekje nga turqit dhe prifti grek,
prapëseprapë shkolla ishte
gjithmonë plot. Vajzat mësonin të
lexonin e të shkruanin shqip dhe
ua mësonin vëllezërve të tyre.”*

— **Edit Durrham, ‘NGATËRRESA
BALLKANIKE 20 VJEÇARE’**

Edhe pse më në fund u kthyen në atdhe me synim për të konsoliduar pushtetin. Fakti që ata kishin qenë patriotë dhe kishin kontribuar kaq shumë në pavarësinë e Shqipërisë, u shpërfill brutalisht. Prona e Institutit Qiriazi u konfiskua për t’u bërë Shkolla e Partisë dhe motrat Qiriazi u dëbuan prej shtëpive të tyre dhe u detyruan të jetonin në një kotec pulash. Kristo Dako kishte

vdekur afër fillimit të luftës dhe ishte varrosur në kishën brenda kopshtit të Institutit. Sipas mbësës së Sevastisë, Viktori Ruli (Dako), trupi i Kristos u zhvarros dhe koka e tij, e mbështjellë me leckë u përdor si top futbolli për një ndeshje në rrugë nga nxënësit e shkollës komuniste. Djemtë e Sevastisë u arrestuan dhe Gjergji, një kirurg mjaft i njohur, vdiq në burg duke mos qenë në gjendje të duronte torturat. Trupit të tij iu mohua varrimi nga e ëma, Sevastia, duke u hedhur në një varr masiv. Sevastia dhe Parashqevia gërmuan në baltë me thonj për të gjetur trupin e Gjergjit gjatë natës. Më në fund e gjetën dhe lanë një gjurmë për të shenjuar vendin në mënyrë që të

ktheheshin në mbrëmje për ta varrosur. Por kur u kthyen ditën tjetër, vendi ishte punuar me traktor dhe trupi i Gjergjit nuk u gjet më kurrë. Sevastia vdiq në 1949 nga ‘një zemër e thyer’.

Më vonë komunistët patën paturpësinë për ta bërë Sevastinë heroinë të kombit, duke bërë një film për të ‘Mësonjëtorja’, edhe pse e kishin përndjekur. Anton Çefa komentoi: “*Për oportunitet dhe hipokrizi politike të pushtetarëve, më vonë, asaj i dhanë titullin ‘Mësuese e Popullit’.*”³¹ Sot mund ta pranojmë me sinqeritet punën e madhe që kjo besimtare ungjillore bëri për Pavarësinë së Shqipërisë.

Gjergj Qiriazhi

(1868 –1912)

Kontributi Kryesor për 1912:

**Delegat në Kongresin e Manastirit Një
prej themeluesve të gazetës
‘Bashkimi i Kombit’ Drejtor i Shkollës
së Parë të Vashave pas
Sevastisë Anëtar i Komitetit të Bajo
Topullit**



Gjergj Qiriazhi

Gjergj Qiriazi, sikurse edhe i vëllai Gjerasimi, ishte një besimtar i bindur që predikonte ungjillin e Krishtit në gjuhën shqipe pa frikë. Edhe ai gjithashtu studioi në Kolegjin Amerikan në Samokov, Bullgari, dhe punoi për Shoqërinë Biblike Britanike dhe të Huaj duke shpërndarë Bibla në shqip dhe libra gramatike. Më vonë, pas vdekjes së të vëllait mori drejtimin e shkollës shqipe të vashave në Korçë për një farë kohe, duke bërë të mundur që shkolla të qëndronte e hapur dhe aktive. Ai u bë një figurë tepër e rëndësishme në lëvizjen për pavarësi. Në 1905 ishte një anëtar themelues 'Për Çlirimin e Shqipërisë', komuniteti i fshehtë i Bajo Topullit që punonin për pavarësinë

së bashku me Grigor Cilkën, Nuçi Naçin dhe Mihal Gramenon. Ai drejtoi gazetën patriotike të komitetit dhe furnizonte shkollën e djemve në Korçë me tekste librash. Në 1908, ishte zëvendëskryetari i Kongresit të Manastirit. Gjergj Qiriazhi ishte një nga themeluesit e botimit të gazetës ‘Bashkimi i Kombit’ e cila botonte shumë letërsi shqipe që bënte të mundur që shqiptarët të mësonin të lexonin dhe të shkruanin gjuhën e tyre. Ai botoi ‘*Hristomathi*’, ‘*Këngë të Shenjtëruara*’, përktheu ‘*Udha e Shtegëtarit*’ e Gjon Bunianit si dhe vepra të tjera.

Parashqevi Qiriazi

(1880 -1970)

Kontributi Kryesor për 1912:

**E vetmja delegate femër në Kongresin
e Manastirit Themeluese e ‘Yll’ i
Mëngjesit’ Mbështeti Pavarësinë si
pjesëmarrëse në Konferencën e Pages
në Paris, 1919**



Parashqevi Qiriazi

Ndërsa ishte ende fëmijë Parashqevia filloi të ndihmonte të vëllanë, Gjerasimin, për t'u mësuar vajzave të tjera të lexonin dhe të shkruanin shqip në shkollën e tij në Korçë. Duke ndjekur hapat e motrës më të madhe, ajo theu tabunë e shoqërisë lidhur me shkollimin e lartë të gruas dhe shkoi të studionte në Kolegjin Robert në Stamboll. Pas kësaj u kthye në Korçë për të punuar si mësuese pranë motrës së saj.

Pas vdekjes së Gjerasimit të dy motrat vazhduan të drejtonin shkollën e vashave. Kundërshtimi u bë kaq i ashpër prej atyre që ishin kundër përhapjes së gjuhës së shqipe, sa që rreth 1907 ato kërkuan ndihmë nga jashtë, duke i bërë apel për mbështetje dhe mbrojtje

Misionit Kongregacional Amerikan (një tjetër shoqëri ungjillore) me të cilët kishin kontakt. Ato siguruan ndihmën e një çifti misionarësh të cilët do të përfshiheshin shumë në Shqipëri dhe do të ndihmonin të mbahej hapur Shkolla e Vashave: Fineas dhe Violet Kenedi.

Në Kongresin e Manastirit Parashqevia pati nderin të ishte e vetmja delegate femër dhe gruaja e parë në histori që mori pjesë në një forum mbarëshqiptar. Ajo shërbeu si sekretare dhe foli në Konferencë për nevojën e një alfabeti të pranuar nga të gjithë. Ajo themeloi shoqërinë 'Yll' i Mëngjesit' në 1909, e cila njihet si e para shoqëri e grave shqiptare. Qëllimi i

shoqërisë ishte të përhapte shkollimin mes grave shqiptare. U ngritën degë në qytete kudo në Shqipëri dhe u shpërndanë libra e gazeta në gjuhën shqipe, të cilat ndihmuan për të ndezur ndjenjën patriotike në vend.

Në 1909 Parashqevia botoi ‘Abetare për Shkollat e Para’ duke u bërë kështu e para autore femër e teksteve shkollore në shqip. Mori pjesë në Konferencën e Paqes në Paris në 1919, duke përfaqësuar të drejtat e shqiptarëve në mbështetje të shpalljes së pavarësisë. Gjithashtu kompozoi një këngë për alfabetin e cila u bë himn kombëtar. Pas Luftës së Dytë Botërore, edhe pse kishte qenë dëshmitare e shkatërrimit të

familjes së saj dhe përndjekjes
komuniste, jetoi deri në 1970 në moshën
90 vjeçare.

Kristo Dako (1878 – 1941)

**Kontributi Kryesor për 1912:
President i shoqërisë ‘Vatra’ në
SHBA Redaktor i gazetës
‘Dielli’ Mbështeti Pavarësinë si
pjesëmarrës në Konferencën e Paqes
në Paris, 1919 Raportoi dhe
dokumentoi mizoritë e kryera ndaj
qytetarëve shqiptarë prej shteteve
fqinj**



Kristo Dako

Kristo Dako u lind në Korçë dhe shkoi në universitet fillimisht në Bukuresht. Ishte atje ku u takua me Sevastinë në 1905. Në fillim dëshira e tij kryesore ishte të ndante besimin e tij të krishterë duke u predikuar njerëzve të tij³², por më vonë u përfshi më shumë në politikë, duke kontribuar në përpjekjen e Shqipërisë për pavarësi. Kristo Dako u arrestua në 1910 nga autoritetet turke dhe u burgos në Gjakovë pas raportimit në gazetën 'Bashkimi i Kombit' se si trupat turke po shtypnin kokat e të moshuarve, burrave dhe grave shqiptare. Lirimi i tij u sigurua dhe ai vazhdoi të shkruante në mbështetje të pavarësisë. Pak pas liritit të tij u martua me Sevastinë në 1910.

Në qershor të 1912 Dakoja shkoi të studionte në Seminarin Teologjik Oberlin në Amerikë. Atje u zgjodh mbi Fan Nolin president i shoqërisë patriotike 'Vatra', e cila ishte një organizatë ombrellë mbi të gjitha shoqëritë e shpërndara shqiptare në SHBA. Gjithashtu u bë redaktor i gazetës 'Dielli', organ i 'Vatrës'. Edwin Jacques shkruan: "*Vatra dha një ndihmesë të pallogaritshme për mërgimtarët shqiptarë kudo në Amerikë, duke i informuar për gjendjen e trazuar në Shqipëri, duke ruajtur trashëgiminë e tyre etnike dhe duke koordinuar veprimet e tyre në përkrahje të Mëmëdheut.*"³³ Dako është autori i veprës 'Cilët janë

Shqiptarët?’ dhe ‘Shqipëria, çelësi për Lindjen e Afërme’.

Pas shpalljes së Pavarësisë në 1912, Kristo Dako vazhdoi punën në mënyrë të palodhshme në mbështetje të pavarësisë së Shqipërisë dhe më vonë për punën e tij mori Urdhërin e Skënderbeut. Kristoja dhe Sevastia u kthyen në Shqipëri dhe shkuan në Korçë në shkollën e vashave e cila kishte nevojë për riparime. Kur ushtarët grekë pushtuan Korçën në 1914, së bashku me Parashqevinë u detyruan të largoheshin me këmbë në drejtim të Sofies. Ata kishin parë me sytë e tyre mizoritë që po kryheshin gjatë luftës Ballkanike dhe Kristoja botoi një raport të hollësishëm të krimeve të luftës që

ndodhën në mënyrë që bota të
dëgjonte.³⁴

Në 1919 mori pjesë në Konferencën e
Paqes në Paris ku mbrojti Pavarësinë e
Shqipërisë dhe debatoi kundër ndarjes
së territorit shqiptar. Ai
takoi Presidentin e SHBA, Woodrow
Wilson dy herë dhe në mënyrë të qartë
i shpjegoi se si mbrojtja e kufijve të
Shqipërisë ishte në rrezik nga
qëllimet grabitqare të vendeve fqinje të
saj. Kjo gjë ndihmoi për të
siguruar mbështetjen e presidentit
Wilsonin dhe të SHBA në mbrojtje të
interesave kombëtare dhe territoriale të
Shqipërisë.

CILET JANE EQIPETARET?



Kristo A. Dako.



MANASTIR
„Tipografia Trgovato Nerkojstcur“
1911

Artikujt e shkruar nga Dakoja u botuan në gazetat më prestigjioze. Si patriot dhe kontribuues ndaj ‘rilindjes’ ai radhitet bashkë me emrat e patriotëve si Fan Noli dhe Faik Konica. Kristoja dhe Sevastia patën dy djem Gjergjin dhe Aleksandrin.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore familja Dako përjetoi vuajtje ekstreme si nga duart e nazistëve, ashtu edhe nga ato të komunistëve (shih më sipër). Sipas mbesës së tij, ai vdiq në 1941 dhe u varros në kopshtin e kishës që ai kishte ndërtuar brenda Institutit Qiriazi. Megjithatë ky nuk ishte vendi i tij përfundimtar i prehjes. Trupi i tij u zhvarros nga komunistët.

Pastor Grigor Cilka

Kontributi Kryesor për 1912:

Anëtar i komitetit të Bajo

**Topullit Predikoi dhe dha mësim në
shqip Delegat dhe folës në Kongresin e
Manastirit në 1908**



Grigor Cilka

Grigor Cilka është një tjetër burrë ku besimi tek Krishti dhe patriotizmi, kanë punuar krah për krah.³⁵ Ai luajti një pjesë të rëndësishme në përpjekjen e Shqipërisë për pavarësi dhe ishte një mik i ngushtë dhe bashkëpunëtor me familjen Qiriazi. Para viteve 1900 shkoi në Amerikë për të studiuar në Seminarin Teologjik të Unionit në Nju Jork dhe pas përfundimit të studimeve, nuk qëndroi në SHBA, por u kthye në Shqipëri për të vazhduar punën e ungjillit. Më pas u bë pastori i Kishës Ungjillore në Korçë e cila ishte themeluar nga Gjerasimi. Është regjistruar se madje edhe kaçakët vinin ta dëgjonin të predikonte dhe u ndryshuan nga fjala e Perëndisë. Gjithashtu ai dha mësim në Shkollën e

Vashave.

Në 1905 Grigori ishte një anëtar themelues ‘Për çlirimin e Shqipërisë’, komiteti sekret i Bajo Topullit që punonte për pavarësinë dhe përfshinte Gjergj Qiriazin, Nuçi Naçin dhe Mihal Gramenon. Grigori shkoi te komuniteti shqiptar në Sofie dhe Bukuresht për të ngritur mbështetje dhe rekrutë.

Sipas vetë statuteve të tyre, qëllimi i tyre ishte: “rilindja e Shqipërisë, duke mbjellë vëllazërinë, dashurinë e bashkimin, duke përhapur qytetërimin me anë të librave që do të shtypen, duke dërguar njerëz në të katër anët e Shqipërisë që të

mbjellin këto ide...”³⁶. Dy vjet më vonë Bajo Topulli ndihmoi vëllanë e vet Çerçizin të formonte çetën e Gjirokastrës së cilës Cilka i ofroi strehë në shtëpinë e tij.

Në 1908 Grigori u arrestua dhe u burgos dy herë për shkak se kishte refuzuar të mbyllte shkollën dhe se kishte dhënë mësim në gjuhën shqipe dhe u lirua vetëm në sajë të ndërhyrjes së Fineas dhe Violet Kenedit, besimtarë ungjillorë amerikanë dhe ‘filo-shqiptarë’.

Cilka ishte një mik i mirë i Mihal Gramenos i cili për të tha: “Cilka ishte zemra dhe shpirti i lëvizjes kombëtare, një burrë i madh dhe i guximshëm, i patundur edhe pse e kishin

burgosur për këtë arsye, ishte i shkolluar. Shërbimet e këtij patrioti kanë çmim të pakrahasueshëm. Cilka meriton shumë faqe në historinë tonë kombëtare duke qenë se ishte, është dhe do të vdesë si një patriot.”³⁷

Në Kongresin e Manastirit në nëntor të 1908 ai ishte pjesë e Komisionit të Alfabetit që përbëhej prej 11 njerëz.

Fineas dhe Violet Kenedi

**Kontributi Kryesor për 1912:
‘Filo-shqiptarë’ Penguan mbylljen e
Shkollës së Vashave në 1910 I bënë
apel Presidentit Woodrow Wilson në
emër të Shqipërisë.**



Fineas dhe Violet Kenedi

Çifti Fineas dhe Violet Kenedi (Phineas and Violet Kennedy) ishin të krishterë ungjillorë amerikanë të cilët erdhën në Korçë në 1908 me Misionin Kongregacional Amerikan me kërkesë të Sevasti dhe Parashqevi Qiriazit. Puna e tyre kryesore ishte predikimi i ungjillit, por

gjithashtu ndihmuan dhe mbështetën lëvizjen kombëtare shqiptare. Fineas u bë i shkëlqyer në gjuhën shqipe dhe nisi të predikonte ungjillin në shqip shpejt pas mbërritjes së tij. Është e qartë që ai e kuptonte domethënien politike të kësaj. Ai shkroi: “herët a vonë zyrtarët e qeverisë do ta kundërshtojnë predikimin tim, sepse ata e konsiderojnë përdorimin e shqipes si një pikëpyetje politike. Atëherë, unë duhet të qarkulloj shkrimet dhe natyrisht forma në latinisht (ose shqip) është ajo që dua të përdor. Ata do ta kundërshtojnë këtë... përdorimi i gjuhës shqipe është një ofendim politik.”³⁸ Ai raportoi se njerëzit dënoheshin nga autoritetet për

shkak të zotërimit të librave shqip përfshirë edhe ungjillin. Një njeri mund të burgosej për tre vjet për zotërim të Biblës shqip. Por kjo nuk e ndaloi Fineasin në punën e tij. Pesë mijë kopje të predikimeve të tij të shkruara u botuan në 1912 nga Gjergj Qiriazhi në Manastir dhe u shpërndanë.

Keneditë ndihmuan për të siguruar lirin e patriotëve shqiptarë që ishin të burgosur nga autoritetet turke. Ata mbërritën në Korçë në kohën kur Grigor Cilka (pastor i Kishës Ungjillore) sapo ishte burgosur. Menjëherë Fineasi nisi të hetonte arrestimin e Cilkës dhe arriti në përfundimin se ishte i pajustificueshëm dhe ishte si rezultat i presionit nga interesat greke dhe turke. Ai e vizitoi

Cilkën në burg çdo ditë dhe pa me sytë e tij kushtet e të burgosurve – të mbipopulluar, të mbajtur pa gjyq dhe vetëm me bukë për të ngrënë. Kenedi shkoi si tek autoritetet turke, ashtu edhe tek Peshkopi grek për të bërë apel për lirimin e Cilkës. Kjo ishte diçka që e bëri disa herë kur u arrestua Grigori.

“Kurrë nuk do ta mbyll shkollën.”

- Fineas Kenedi

Në 1910 Fineasi erdhi në ballë të luftës për pavarësi kur autoritetet turke u përpoqën të mbyllnin të gjitha shkollat në gjuhën shqipe. Si qytetar amerikan, Fineasi ishte në gjendje të shpallte imunitet ndaj këtij ligji dhe kështu

Shkollës së Vashave në Korçë iu dha emri ‘Shkolla Amerikane’ dhe Fineasi mundi ta mbante të hapur. Në atë kohë ishte e vetmja shkollë shqipe që funksiononte në vend.

Fineasi u diplomua në Universitetin Princeton. Ai kishte studiuar atje në të njëjtën kohë kur presidenti i ardhshëm i SHBA punonte si profesor. Për shkak të kësaj njohjeje Keneditë patën pak influencë me Woodrow Wilson kur ishte President i SHBA të cilën e përdorën për të bërë apel për kauzën e Shqipërisë. David Young shkruan: *“Keneditë e përfshinë veten me energji dhe përkushtim qysh nga fillimi i kohës së tyre në Shqipëri në kauzën e pavarësisë*

së Shqipërisë, duke i shtyrë më përpara pretendimet e Shqipërisë nëpërmjet dërgimit të letrave, artikujve dhe telegrameve tek njerëzit me influencë. Woodrow Wilson... refuzoi të nënshkruante traktatin e paqes të 1919 në Konferencën e Parisit derisa ky të përmbante një garanci të së drejtës së vet-qeverisjes për shqiptarët... ”³⁹

Pasthënie - Çfarë është ungjilli?

Për shumë shqiptarë jetët e këtyre atdhetarëve po dëgjohen sot për herë të parë. Gjatë komunizmit historitë e tyre shpesh janë fshehur si në rastin e Kristo Dakos. Në raste të tjera historitë e tyre deformoheshin që t'i vinin për shtat propagandës ateiste. Kjo shihet në rastin e Gjerasim Qiriazit. Pretendohej se ai ishte vetëm patriot që e përdori fenë për t'i shërbyer qëllimeve të tij nacionaliste. Faktet nga dorëshkrimet e tij tregojnë

të kundërtën. Roli i madh që ka luajtur ungjilli në historinë e Shqipërisë ishte një fakt që e vinte në siklet makinerinë e propagandës komuniste. Por e vërteta nuk mund të fshihet për shumë gjatë, herët apo vonë do të nxjerrë krye. Përveç vlerës së tij letrare në progresin e gjuhës shqipe, mesazhi i ungjillit të Jezus Krishtit ishte frymëzimi më i madh i patriotëve të përmendur në këtë libër. Kjo histori nuk është unike. Kudo nëpër botë njerëzit kanë bërë sakrifica të mëdha personale për t'u sjellë ungjillin të tjerëve dhe janë frymëzuar nga mesazhi i tij për të ndihmuar ata në nevoja fizike. Emra të mëdhenj njerëzish si Martin Luter King, Nënë Tereza deri

te Majkëll Faradej të gjithë deklaruan frymëzimin nga ungjilli. Pse është kjo? Çfarë ka ungjilli që është kaq i rëndësishëm sa që i bën njerëzit të punojnë kaq shumë dhe të heqin vuajtje të tilla vetëm që të tjerët të dëgjojnë për të? Çfarë ka ai që i frymëzon njerëzit të shfaqin dashuri dhe dhembshuri? E vetmja mënyrë për të gjetur përgjigje për këto pyetje është të kuptosh mesazhin e ungjillit për veten tënde. Më poshtë, pastor Gentian Dogani i përgjigjet pyetjes ‘Çfarë është ungjilli?’.

I dashur lexues, *Do të kërkoja vëmendjen tënde ndërsa lexon këtë shpjegim të thjeshtë të ungjillit. Ungjill do të thotë lajm i mirë. Nga vetë*

domethënia i këtyre fjalëve, kuptojmë se Perëndia ka një lajm të mirë për ty. Ky lajm i mirë ka të bëjë me faljen e të gjitha mëkateve (fajeve) të tua. Thjesht duke besuar se Jezus Krishti vdiq në kryq duke paguar çmimin për mëkatet në vendin tënd. Perëndia ofron të pajtohesh me Të.

Paralajmërim

Ndoshta kjo fjalë ‘pajtim me Perëndinë’ të çudit, sepse ndoshta asnjëherë nuk të ka shkuar në mendje se je në armiqësi me Perëndinë. Por, mik i dashur, besojë këtë, sepse vetë fjala e Perëndisë thotë:

“nuk ka dallim, sepse të gjithë mëkatuan dhe nuk e arrijnë lavdinë

e Perëndisë” (Romakët 3:22-23)
Gjithashtu tek Romakët 6:23
thuhet: “paga e mëkatit është vdekja,
por dhurata e Perëndisë është jeta e
përjetshme nëpërmjet Krishtit Jezus,
Zotit tonë.”

Vetë fjala e Perëndisë deklaroi se të
gjithë jemi fajtorë dhe ti, mik i
dashur, nuk bën përjashtim. Ndoshta ke
menduar se je njeri i mirë, i drejtë dhe
i ndershëm. Dhe kjo, sepse deri tani je
krahasuar me njerëz të tjerë, por,
sido që të kesh menduar, sipas fjalës së
vërtetë të Perëndisë ti je mëkatar dhe i
zhytur në mëkat. Vetë mendimet e tua,
fjalët e tua, veprat dhe dëshirat e tua
dëshmojnë për mëkatet e tua. Për më

*tepër fjala e Perëndisë tashmë thotë se
çdo njeri është mëkatar dhe se nuk ka
as edhe një të drejtë. Dhe fjala e
Perëndisë nuk mund të gënjejë.*

*Në Bibël, tek Galatasve 5:19-21 na
jepet një listë mëkatesh, ku çdo njeri i
sinqertë e pranon se gjendet shkelës i
shumë të tillave: “Veprat e mishit janë
të shfaqura dhe janë; kurorëshkelja,
kurvëria, papastërtia, shthurja,
idhujtaria, magjia, armiqësia, grindja,
xhelozia, zemërimi, rivaliteti,
përçarjet, tarafet [thashethemet],
smira, vrasjet, të dehurit, grykësia dhe
të tjera të ngjashme me këto për të
cilat po ju paralajmëroj, sikurse ju
thashë edhe më parë se ata që i bëjnë*

këto gjëra, nuk do të trashëgojnë mbretërinë e Perëndisë.”

Thuhet se veprat e mishit janë shfaqur. Këto mëkate nuk janë imagjinare. Ato sundojnë në marrëdhëniet njerëzore. Hidhi sytë rrotull dhe shiko se sa keq është gjendja e njerëzve. Me fodullëk, krenari, përçmim, abuzim, imoralitet, mashtrim, gënjeshtër, vrasje, divorce, aborte, etj. Kudo shikojmë gjendjen e rënë të njeriut pa Perëndinë. Është absurde të thuash se mëkati është një trillim i fesë. Jo, veprat e mëkatshme të njerëzve, janë të dukshme në mes nesh.³⁴

Shpëtim

O mik, ashtu sikurse ti je dëshmitar se

je i gjallë dhe jeton, është po kaq e vërtetë se je mëkatar dhe se je nën zemërimin e Perëndisë. Paga e mëkatit është vdekja. Nëse nuk do ta vlerësosh lajmin e mirë të faljes së mëkateve, një ditë do të paguash në gjyqin e Perëndisë për këto mëkate, për të cilat të ofrohet tani mundësia për t'u pajtuar me Perëndinë përmes sakrificës së Birit të tij, Jezus Krishti.

Lajmi i mirë i ungjillit është se Jezus Krishti, Biri i Perëndisë, vdiq në kryq për të paguar për mëkatet e tua. Ai pagoi me jetën e vet çmimin që kërkohej nga Perëndia për shkeljen e ligjit të Tij. Lajmi i mirë, ungjilli pra, përfshin faljen e mëkateve dhe premtimin e jetës së përjetshme. Jezus

Krishti vdiq për mëkatet tona dhe u ringjall për shfajësimin tonë. Ringjallja e Jezus Krishtit është shpresa jonë për jetën e përjetshme.

Jetëndryshues

Ungjilli, pra, është një lajm jetëndryshues. Sepse kriminelët janë bërë të butë dhe të paqtë, gënjeshtari thotë të vërtetën, vjedhësi kthen atë që ka vjedhur, mashtruesi heq dorë nga mashtrimet e tij, ai që pasurohet në mënyrë të pandershme heq dorë nga pandershmëria e tij, ai që flet me gjuhën e tij fjalë të ndyra pastron të folurin e tij, etj. Ungjilli pra është fuqia e shpëtimit për këdo. Kjo do të thotë se vetëm me anë të këtij lajmi mund të pastrohemi nga fajet tona dhe,

*kështu, të marrim pjesë në premtimet e Perëndisë bashkë me ata që besojnë dhe e duan Krishtin. Është më anë të ungjillit që mëkatarët pastrohen nga mëkatet e tyre, duke ndryshuar jetët e tyre në njerëz plot zell dhe devotshmëri për të bërë të mirën. Kur lajmi i mirë i pendesës për mëkatet në Jezus Krishtin besohet, mëkatarët ndryshojnë. Ungjilli i frymëzon njerëzit të duan tjerët. Këto fjalë të Jezusit kanë frymëzuar miliona: **“Duaje të afërmin tënd porsì vetveten” (Marku 12:31) dhe “Ashtu siç dëshironi që t’ju bëjnë juve njerëzit, edhe ju u bëni atyre njësoj” (Luka 6:31)** Lexues i dashur, nëse e kupton se je mëkatar, e vetmja*

gjë që të kërkon Perëndia është të besosh (të pendohesh për mëkatet e tua duke besuar në sakrificën e Jezusit) në vdekjen dhe ringjalljen e Birit të Ti, Jezus Krishti. ³⁵ Vdekja e Jezusit na siguron se paga për mëkatin është paguar, dhe ringjallja e tij është shpresa jonë për jetën e përjetshme.

“Sepse Perëndia e deshi atë botën sa dha birin e tij të vetëmlindurin, që, kushdo që beson në Të, të mos humbasë, por të ketë jetën e përjetshme.” (Gjoni 3:16.)

Përgjegjësia jote

Besoji Jezus Krishtit, lutju atij. Gjej një kishë ku predikohet fjala e Perëndisë (Bibla) dhe ku në qendër te

predikimeve është Jezus Krishti, biri i Perëndisë, që vdiq për mëkatet tona, duke na ofruar kështu pajtim me Perëndinë. Nëse ky mesazh i shkurtër i ungjillit është i qartë për ty, do të të bëja thirrje të bashkoheshe me ata që besojnë dhe mblidhen për të adhuruar Perëndinë dhe Jezus Krishtin të djelave apo ditët e tjera të javës. Nëse ky mesazh të ka shtyrë për të menduar për gjërat shpirtërore, për Perëndinë, vdekjen, gjyqin, mëkatin, etj, merr një Bibël dhe lexoje ungjillin vetë. Zoti të dhëntë paqe duke drejtuar rrugën tënde drejt së vërtetës. Një shërbëtor në kishën e Jezus Krishtit.

Lexime të mëtejshme:

- Lëvizja Protestante Midis Shq
1991, David Young,
TENDA, Prishtina
- Rrugë Biblike në Shqipërinë e
Alexander Thompson, AEM

Shënimet:

1. David Young, Lëvizja Protestante Midis Shqiptarëve 1908-1991, TENDA, Prishtina, fq. 55.
2. Edwin Jacques, Shqiptarët, KARTË E PENDË, fq. 320.
3. Albanologu i mirënjohur Robert Elsie flet për praninë e Krishterimit protestant në Shqipëri para Luftës së Dytë Botërore në librin e tij ‘Historical Dictionary of

Albania.', fq. 371-372.

4. Farlati, *Illyricum Sacrum*,
5. Gjon Buzuku, *Meshari*,
Hyrje.
6. Pjetër Bogdan, *Cuneus Prophetarum*.
7. Për më shumë mbi ungjillin në letërsinë shqipe, shih 'Kodi Biblik në letërsinë shqiptare', Femi Cakolli, TENDA, Prishtina.
8. John Quanrud, *A Sacred Task*, 2002, fq. 53 (përkthim i autorit)
9. David Young, *Shqipëria: Çmimi*, AEM, fq. 10.
10. Edwin Jacques, *Shqiptarët*,

11. Shih p.sh. Alipashaida, Haxhi Shehretit, i cili gjithashtu ishte një mjek në oborrin e Ali Pashës.
12. Xhevat Lloshi, Rreth Alfabetit të Shqipes, 2008, fq. 112-113.
13. Robert Elsie, Historical Dictionary of Albania, fq. 249
14. Informacion për Kristoforidhin nga: Robert Elsie, Historical Dictionary of Albania, Biography of Kristoforidhi in 'Ylli i Vogël Lart në Qiell', Argeta-LMG,

Tirane 2007.

15. The Battle for Albania,
AEM.
16. Alexander Thompson, Rugë
Biblike në Shqipërinë e
Vjetër, AEM
17. David Young, Shqipëria:
Çmimi, AEM, fq. 19.
18. Shih për shembull fjalët e
Qiriazit në ‘Captured By
Brigands’ më poshtë.
19. John Quanrud, A Sacred
Task, 2002, fq. 38 (përkthim i
autorit).
20. John Quanrud, A Sacred
Task, 2002, fq. 53 (përkthim i
autorit).

21. Ibid Pg57, 64-64.
22. Robert Elsie, Historical Dictionary of Albania, fq. 377.
23. Skënder Luarasi, Gjerasim Qiriazi, fq. 27.
24. Letërsia shqipe u mallkua nga patriarku ortodoks grek dhe kërcënoi me shkishërim të gjithë ata që guxonin të lexonin letërsi shqipe.
25. Gjerasim Qiriazi, Captured by Brigands, London 1902, fq. 8.
26. Gjerasim Qiriazi, Captured by Brigands, AEM, fq. 10-11.
27. Gjerasim Qiriazi, Captured

- by Brigands, AEM, fq. 125
28. Gjerasim Qiriaz, Kristomaci, fq. 113.
 29. Edwin Jacques, Shqiptarët, KARTË E PENDË, fq. 325.
 30. John Quanrud, A Sacred Task, 2002, fq. 180.
(përkthim i autorit)
 31. Anton Çefa, Historia e familjes patriotike Qiriaz, ZemraShqiptare.net.
 32. David Young, Lëvizja Protestante Midis Shqiptarëve 1908-1991, TENDA, Prishtinë, 2012, fq. 40
 33. Edwin Jacques, Shqiptaret,

KARTË E PENDË, fq. 339

34. Shih faqen e internetit të
Robert Elsie-t:
www.albanianhistory.net/texts
 35. David Young fq. 139
 36. Edwin Jacques, Shqiptaret,
KARTË E PENDË, fq. 293
 37. Michal Grameno, Kryengritje
Shqiptare, 1925, fq. 43-44.
 38. David Young, Lëvizja
Protestante Midis
Shqiptarëve 1908-
1991, TENDA, Prishtina, fq.
39 (përkthim i autorit)
 39. David Young fq. 139.
-

Në Vlonë më 15/28 të Jeshitës së tretë 1924/1925

Pas falorët që tha L. Kujtimin "Banal. Kujtim
 Bëa, me të cilat kemi vepruar e me të cilat
 të cilin udhëhojë sot Shqipëria, të gjithë delja
 sot me një të venduar që Shqipëria
 sot të bëhet në rreth, e kështu e e mirënjohje

توفیق بر من بفرماید که در این راه حق و باطل را از هم جدا کنم و در این راه حق را پیروی کنم و باطل را نهی کنم. و در این راه حق را پیروی کنم و باطل را نهی کنم. و در این راه حق را پیروی کنم و باطل را نهی کنم.

Im Auftrag des Kaiserlichen
J. K. Hofrath, Elmsberg, Vol. 100, 1

2. ^{acorn feeding} ^{Whiting} Redhead ^{Alfred}

Abdi Alasulawa Muktamadul Calypt Dgn

Zinnr. Abbas Kaminaz

Majro din
Bakr
Aemal
elbasari
Hassan Salih Gubbi
Boratti
Dimitri Bogdanoff

1. Morad Topram Din. 7. 2. 1897
 2. Das Parating Pond's Lake
 3. 2. 1. 1897 Bom. Ajing
 4. 2. 1. 1897 Speret. Ho
 5. 2. 1. 1897 Phang. 7. 1897
 6. 2. 1. 1897 Lef. Nni
 7. 2. 1. 1897 D. H. Muttig
 8. 2. 1. 1897 D. H. Muttig

Mustafa Amin Kruga

M. Teris vobis

Yours

Ne zylu lutyja,

Zubdi Ohia